



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:057464

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05396863

KF.nr.205/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Korporata Energjetike e Kosovës” Sh.A., me seli në rr. “Sheshi Nëna Terezë”, rr.36 në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson G.B. jurist i diplomuar, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.K., lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit të Doganës së Kosovës nr.01.3.2.2/507/2018 A1.H. i datës 02.03.2021, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuarit të palës paditëse G.B. dhe në prani të përfaqësuesit të palës së paditur M.K., me datë 12.02.2024 morri këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “Korporata Energjetike e Kosovës” Sh.A., me seli në Prishtinë, si e bazuar;
- II. ANULOHET aktvendimi me nr.01.3.2.2/507/2018 A1.H. i datës 02.03.2021 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë;
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “Korporata Energjetike e Kosovës” Sh.A., me seli në Prishtinë, t’ia kthejë mjetet e paguar në emër të taksës doganore në vlerë prej 481,699.41 €, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e pagesës 13.12.2018 e deri në kthimin e plotë, në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A R S Y E T I M

Paditësi “Korporata Energjetike e Kosovës” Sh.A., me seli në Prishtinë, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 26.03.2021, ka iniciuar kontest tregtar-administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/507/2018 A1.H. i datës 02.03.2021, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit “Korporata Energjetike e Kosovës” Sh.A., të anulohet aktvendimi 01.3.2.2/507/2018 A1.H. i datës 02.03.2021 i Doganës së Kosovës si dhe aktvendimi 03.1.1-2018-448/1 i datës 25.07.2018 i Doganës së Kosovës – Sektori për Kontrolla pas Importuese dhe të detyrohet e paditura që ti kthej paditëses shumën prej 481,699.41 € të paguar si rezultat i vendimit të anuluar me kamatë ligjore prej 8 %, nga data 13.12.2018 deri në ditën e kthimit të mjeteve si dhe në emër të taksës për padi në lartësi prej 950 €. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë thënieve dhe pretendimeve të paraqitura në padi, duke theksuar se paditësja ka pranuar përgjigjen në padi të paditurës ashtu që konsiderojnë që në përgjigje në padi në mënyrë të përgjithësuar është kontestuar padia e paditëses ndërsa paditësja konsideron që e paditura sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelore Prishtinë me numër A.nr 2685/18 të Divizionit Fiskal, nuk ka arritur të sqaroj çështjen për lirim të taksës doganore andaj kanë konsideruar që sipas provave dhe pretendimeve të paraqitura sipas padisë së mëhershme dhe sipas padisë ndaj vendimit të paditurës në rivendosje që kërkesëpadia e paditëses është e bazuar. Gjykatës i ka propozuar që të anulohet vendimi i atakuar në padi dhe të detyroj të paditurën që të bëjë kthej shumën prej 481,699.41 € me kamatë ligjore prej 8 % nga data 13.12.2018 e deri në pagesën definitive si dhe vlerën prej 950 € në emër të taksës për padi.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 05.10.2021 e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Ka theksuar se aktvendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Ndërsa seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës ka deklaruar se e kundërshtojnë në tërësi kërkesëpadinë dhe padinë e paditësit. Tutje ka deklaruar se vendimi kontestues 01.3.2.2/507/2018 është tërësisht i bazuar në KDA andaj e pretendimet e paditësit se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk ekzistojnë dhe nuk mund të mbështeten me asnjë provë të vetme. Ka theksuar se Dogana e Kosovës në ri procedurë edhe njëherë ka sqaruar se ku është bazuar kur ka lënë në fuqi aktvendimin kontestues duke mos aprovuar kërkesën e paditësit. Gjithashtu ka sqaruar të gjitha

vërejtjet e gjykatës siç janë të cekura në arsyetimin e këtij aktvendimit. Gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim në të cilën e refuzon kërkesëpadinë dhe padinë e paditësit dhe e lë në fuqi vendimin kontestues si të drejtë dhe të ligjshëm. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurë provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të datës 12.02.2024, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi 01.3.2.2/507/2018 i datës 02.03.2021, Aktgjykimi A.nr.2685/18 i datës 09.02.2021, fletëpagesa e bankës Raiffeisen Bank 13.12.2018, Aktvendimi i DK 03.1.1-2018-448/1 datës 25.07.2018, Vendimi nr. 14/7 i datës 06.10.2017 i Qeverisë së Kosovës, Vendimi i ATK-së nr. 555/2018 me aneks të vendimit të datës 27.07.2018, email i datës 23.05.2018, 24.05.2018, Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 08/40 datës 11.04.2018, email i datës 27.07.2018, përgjigja në padi, Vendimi i Qeverisë nr.15/07 i datës 06.10.2017, Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 13/07 i datës 06.10.2017, procesverbal i lëndës A.nr.2685/18, Aktvendim 01.3.2.2/507 datës 04.08.2018, email i datës 17.07.2018 me titull kërkesë për interpretim të vendimit 08/40 të Qeverisë të Republikës së Kosovës, email i datës 27.06.2018 me titull kërkesë për interpretim të vendimit 08/40 të Qeverisë të Republikës së Kosovës, Vendimi i ATK-së nr.134/2018 dhe aneks i vendimit i datës 26.01.2018, email i datës 07.06.2018, email i datës 11.06.2018, email i datës 24.07.2018, Vendimi i ATK-së nr.315/2018 i datës 16.03.2018 dhe anekset e vendimit- të korrigjuara datës 16.03.2018, kërkesë për rishqyrtim të aktvendimit datës 22.08.2018, email i datës 23.05.2018 (dy email të datës së njëjtë), email i datës 24.05.2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi dhe seancë, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar-administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, shkresat e lëndës, aktvendimit kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se paditësi ka paraqitur DUD-at R-6714/24.05.2018, 10372/04.06.2018, 10370/04.06.2018, 10618/06.06.2018, 15324/12.06.2018, 15325/12.06.1, 11 674/20.06.2018, 11672/20.2018, 1662/20.06.2018 dhe 37363/02.07.2018, për zhdoganim me procedurë 4000 LPR, në këtë rast janë procesuar dhe janë pranuar si të tillë. Më tutje Sektori

i Kontrollës pas Importuese me datë 25.07.2018 duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka sjell Aktvendimin nr.2018-448/1 duke e ndryshuar procedurën e deklaratave nga 4000 LPR në 4000 000, duke e obliguar këtu paditësin me detyrime shtesë. Po ashtu jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi ka ushtruar ankesë pran Doganës së Kosovës e për të cilën ankesë Dogana e Kosovës me datë 04.10.2018, ka sjell Aktvendim nr. 01.3.2.2/507 si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin vendim është refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë, kundër të cilit vendim paditësi me padinë e datës 09.11.2018 ka iniciuar konflikt administrativ. Nuk është kontestuese as fakti se Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative Divizioni Fiskal me numër A.nr.2685/18 ka sjell Aktgjykim me të cilën e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe ka anuluar aktvendimin nr.01.3.2.2/507 i 04.10.2018 i Doganës së Kosovës, dhe e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje. Tutje Dogana e Kosovës, duke vepruar sipas Aktgjykimit A.nr.2685/18 të datës 25.01.2021 ka sjell Aktvendim me të cilin e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë “Korporata Energjetike e Kosovës”-Sh.A., dhe ka lënë në fuqi aktvendimi 03.1.1-2018-448/1 i datës 25.07.2018 i lëshuar nga Sektori i Kontrollës pas Importuese.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës në procedurën e rishqyrtimit të aktvendimit 03.01.1-2018-448/1 të datës 25.07.2018 e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit si të pabazuar me arsyetim se Dogana e Kosovës ka ardhur në përfundim se paditësi nga Administrata Tatimore e Kosovës përmes ILP Ankesit një (1) nuk është pajisur me autorizim për lirim nga tatimi për lëndën e parë pra pjesë rezervë në rastin konkret nuk mund të lirohen nga taksat doganore bazuar në vendimin e Qeverisë 08/40 të datës 11.04.2018.

Gjykata nga Vendimi Qeveritar nr.08/40 të datës 11.04.2018, ka gjetur se janë liruar nga tatimi Doganor të gjithë pjesët rezervë për subjektet e regjistruara nga Administrata Tatimore e Kosovës si subjekt prodhues (subjekte të cilat posedojnë ndonjë autorizim për lirim nga tatimi për lëndën e parë, nëse posedojnë këto dokumente atëherë për zbatim të vendimit 08/40 në rubrikën 37 mund të përdorin 4000 LPR për lirim nga tatimi Doganor prej 10 %.

Gjykata nga vendimi i Administratës Tatimore të Kosovës ILP TVSH: NR.134/2018 dhe aneks i vendimit të datës 26.01.2018, ka gjetur se i njëjti ka aprovuar kërkesën

nr.05/06/323 të datës 19.01.2018, e këtu paditësit për lirim në importim të lëndës së parë bazuar në Ligjin për TVSH Nr.05/L-037, Udhëzimit Administrativ Nr.03/2015 për zbatimin e Ligjit për TVSH, si dhe vendimeve të Qeverisë Nr.13/2017 dhe Nr.14/2017 për Vajrat e naftës për proces prodhimit-me një përmbajtje sulfuri jo më tepër se 0,001% ndaj peshës, me numër të kodit doganor 27101943, për lëndë djegëse për proces të prodhimit Mazut me një përmbajtje sulfuri me tepër se 0.1% ndaj peshës por jo më tepër se 1% ndaj peshës. Pra ky vendim është korigjuar me vendimin ILP TVSH: NR 315/2018 të datës 16.03.2018.

Gjykata nga komunikimet zyrtare përmes postës elektronike të datës 23.05.2018 dhe ate të datës 24.05.2018, ka konstatuar se Dogana e Kosovës përkatësisht zyrtari doganor ka komunikuar me përfaqësuesin e këtu paditëses dhe nga ky komunikim, zyrtari doganor ka theksuar se në qoftëse këtu paditësja posedon vendimin e ATK-së për lirim të lëndës së parë atëherë për lirim të pjesëve rezervë nuk nevojitet vendimi me kode, por vetëm ndonjë vendim paraprakë për lirim të lëndës së parë në qoftes posedon.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se paditësi me vendimin Administratës Tatimore të Kosovës ILP TVSH: NR.134/2018 aneks i vendimit të datës 26.01.2018 dhe vendimin ILP TVSH: NR 315/2018 të datës 16.03.2018, në kohën e zhdoganimit ka pasur vendim për lirim nga tatimi në lëndën e parë.

Prandaj nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata përfundimisht cilëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, me lirim nga taksa doganore. Nisur nga kjo, gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 292 pika b, të KDAK-së nr.03/L-109, nenit 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, miratoj kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit, t'ia kthejë mjetet e paguara në vlerë prej 481,699.41 € me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga dita e pagesës së mjeteve me datë 13.12.2018, e deri në pagesën definitive në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Gjykata konstaton se shuma e paguar nga ana e paditësit në emër të taksës doganore u vërtetuar nga Fletëpagesa e Bankës Raiffeisen Bank e datës 13.12.2018, nga e cila Fletëpagesë

vërtetohet se mjetet janë lëshuar në llogari të Doganës së Kosovës në shumë prej 481,699.41 €

Lidhur me kamatën Gjykata ka vendosur konform nenit 378 të LMD-së, me të cilin përcaktohet se “Përveç borxhit kryesor (kryegjëja), debitori po ashtu ka për detyrim edhe kamatën, në qoftë se e njëjta është përcaktuar nga ligji ose në rast se kreditori dhe debitori ashtu kanë kontraktuar”, dhe nenit 382, lidhur me kamatëvonesën, paragrafi 1. “*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën*”, dhe paragrafi 2. “*Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.205/22, datë 12.02.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2021:057464
Datë: 29.02.2024
Numri i dokumentit: 05396863